



Nr. _____ prot.

Tiranë, më 21.6.2021

- Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 21.6.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besim Hajdarmataj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 5.12.2019, është njoftuar vendimi nr. 200, datë 16.10.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Besim Hajdarmataj, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, një komision prej tre vëzhguesish të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM), në datën 4.12.2019, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin: “Rekomandim për paraqitje ankimi”.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vlerësim edhe të Rekomandimit të ONM-së, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar ankim.

Kolegji i Posaçëm i Apelit¹, me datë 16.6.2021, ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, shkresën nr. ***/*** regj., të gjyqtarit kryesues të çështjes nr. 3 regj., datë 14.1.2021, që i përket ankimit kundër vendimit nr. 200/2019. Bashkëlidhur kësaj shkrese është përcjellë paraprakisht dokumentacioni i sjellë nga vetë subjekti i rivlerësimit, në funksion të ankimit të paraqitur, i cili, referuar inventarit të hartuar në Kolegj nga Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve, përmban 177 faqe. Lidhur me këto akte, Komisioneri Publik, bazuar

¹ Me shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.6.2021.

në nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rezervon të drejtën e shprehjes mbi to pas administrimit të tyre në seancë gjyqësore.

Në këto kushte, Komisioneri Publik, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e tij, çmon se vendimi nr. 200/2019 është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu nënshtruar juridiksionit rivlerësues dhe kontrollues nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Në vijim paraqesim analizën e shkaqeve të ankimit, lidhur me rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, të pasurisë, si dhe vlerësimin tërësor të çështjes, duke iu referuar fillimisht jurisprudencës dhe orientimeve të dhëna nga Kolegji, të cilat do të ndihmojnë në zgjidhjen drejtësisht të çështjeve objekt ankimi:

1. Për kriterin e aftësive profesionale, ndër të tjera, Kolegji, në vendimin orientues (JR) nr. 29/2019, është shprehur se: [19.2... *kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht në të aftë, me mangësi apo të papërshtatshëm, kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm dhe tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm. Më tej, Kolegji ka konsideruar: [... me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.]*

1.1 Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit dhe ONM-së, janë depozituar disa denoncime nga publiku kundrejt subjektit të rivlerësimit, në të cilat, ndër të tjera, referohen pesë çështje penale, të hetuara respektivisht nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, prokuroria e Kurbinit/Laç dhe ajo e Durrësit, në kohën kur në drejtimin e tyre ishte subjekti i rivlerësimit, z. Hajdarmataj. Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, herë në cilësinë e prokurorit të çështjes dhe herë si drejtues i Prokurorisë, duket se nuk ka ushtruar si duhet detyrat e tij funksionale, e për pasojë, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, dhe në përfundim, për çështjen me numër 129/2010 ka vendosur ta transferojë për inspektim pranë organit kompetent.

1.2 Lidhur me vlerësimin nga i cili duhet të udhëhiqet Komisioni, përpara transferimit të çështjeve, referuar nenit 59/4 të ligjit nr. 84/2016, si më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin (JR) nr. 2/2020, ka mbajtur qëndrimin se: [32.5. ... *praktikat të cilat transferohen për inspektim në organet kompetente, në parim duhet të përmbajnë shkelje joserioze, pa pasojë të rënda procedurale për palët, brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016, pasi në rast të kundërt do të kemi gjendje të përsëritur të gabimeve në gjykim, çka dëshmon për praninë e mangësive profesionale të evidentuara ... Këto gabime nga Komisioni duhen vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2 e të njëjtit ligj dhe, sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme].*

1.3 Në konsideratë të këtij qëndrimi të Kolegjit, si dhe rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik çmon se të dhënat e dala nga çështja e transferuar, së bashku me të dhënat e tjera të rezultuara nga vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale, e jo vetëm, do të duhej të shqyrtoheshin dhe vlerësoheshin nga Komisioni në kuadër të juridiksionit kushtetues rivlerësues². Referuar kësaj praktike të Kolegjit, duket se Komisioni nuk mban në konsideratë

² Referuar dhe qëndrimin të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 2/2020, prg., 31.3.

hapat pararendës të vlerësimit të shkeljeve, para se të vendoste transferimin e çështjes në organin kompetent, në raport me: (i) respektimin e afatit që parashikon neni 117 i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, për efekt të afatit të parashkrimit 5-vjeçar dhe (ii) vlerësimin e shkeljeve sipas parashikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2 të këtij ligji.

2. Për kriterin e pasurisë, në jurisprudencën e Kolegjit, në mënyrë konstante, kanë gjetur trajtim çështjet, si: të ardhurat e ligjshme nga burime të ligjshme, vlera provuesë e deklaratave periodike, rëndësia e dokumentacionit provues të pretendimeve të subjekteve, metodologjia që duhet të ndiqet për kryerjen e analizës financiare dhe zërave të saj³ në funksion të vlerësimit të burimeve të ligjshme, cilësimi i personave të lidhur/tjerë të lidhur⁴, kufijtë dhe proporcionaliteti i kontrollit të kriterit të pasurisë, deklaratat noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit⁵ etj..

3. Për vlerësimin tërësor të çështjes, Kolegji, në vendimin (JR) 10/2021, ndër të tjera, ka vlerësuar se: [11. ... *institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm te publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë te qytetarët. Ka një sërë sjelljesh nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënive të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimit në situatën e konfliktit të interesit, paaftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave private përpara interesit publik etj.* Kolegji, nëpërmjet jurisprudencës së tij⁶, ka konsideruar se mund të konkludohet se është shkelur besimi i publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistojnë rrethanat që bëjnë të mundur aplikimin e nenit 61, pikat 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit për shkak të vetë rëndësisë që paraqet arritja e këtij qëllimi.

4. Komisioneri Publik, duke mbajtur në konsideratë sa u parashtrua më lart, lidhur me interpretimin e dispozitave të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, jurisprudencës të konsoliduar të Kolegjit, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, në vijim parashtron analizën e shkaqeve të ankimit:

I. Analiza e shkaqeve të ankimit

I.A. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

5. Komisioni, duke marrë shkas nga denoncimet e publikut, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime dhe i ka kaluar barrën e provës, për gjetjet e rezultuara nga studimi i akteve të procedimeve penale, objekt i këtyre denoncimeve. Për këto çështje, Komisioni i ka kërkuar informacion dhe vlerësim edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim referuar *KLP*), i cili, me shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.5.2019, ka përcjellë analizën e gjetjeve për rastet e kërkuara.

³ Si shembull, trajtimin e të ardhurave me burim nga pagesa e bonusit të karburantit, referohuni në vendimin (JR) nr. 35/2019, prg., 11.6.2.

⁴ Në vendimin (JR) nr. 21/2020, ka gjetur me vend të theksojë nevojën për të orientuar Komisionin, mbi [... mënyrën e arsyetimit në të ardhmen, në drejtim të nevojës për kualifikimet e duhura ligjore të situatave faktike, veçanërisht në funksion të të provuarit të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve, në lidhje me cilësimin e personit/personave të tretë, si person/persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, apo të marrëdhënies konkrete të subjekteve të rivlerësimit me pasuritë e caktuara].

⁵ Referuar vendimeve të Kolegjit (JR) nr. 6/2018, prg. 35 dhe 36; nr. 11/2019, prg. 27.12.1; nr. 34/2019, prg. 85.2; nr. 23/2020, prg. 26.2; nr. 11/2021, prg. 20.2 etj.

⁶ Referuar arsyetimit të Kolegjit në vendimet (JR) nr. 26/2019, prg. 113; nr. 31/2019; nr. 10/2021, prg. 10.

6. Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se gjetjet dhe mangësitë e konstatuara janë të tilla që, sipas orientimit të Kolegjit, mund të vlerësohen sipas treguesve përkatës të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për sa kohë ka të dhëna që lidhen me tregues të natyrës cilësore, të vlerësueshme dhe të matshme, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, konkretisht:

7. ***Për çështjen e transferuar, procedimi penal nr. ***, i vitit 2010, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, në të cilën subjekti ka pasur rolin e drejtuesit dhe të prokurorit të ngarkuar me hetimin e çështjes***

7.1 Në denoncimin e paraqitur, ndër të tjera, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka miqësi me shtetasin ***. ***, shtetas me probleme të theksuara ligjore dhe i skeduar për disa vepra penale, duke udhëtuar shpesh së bashku jashtë shtetit nga viti 2010 deri në vitin 2016. Nisur nga të këto të dhëna, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin ka vënë në dispozicion një kopje të fashikullit të këtij procedimi penal.

7.2 Nga përmbajtja e akteve të procedimit penal nr. ***/2010, pa kaluar në përsëritje të zgjeruar të rrethanave të rastit, paraqitur në ankim, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes⁷, më datë ***.7.2011, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2010, duke arsyetuar se: “... jemi përpara rasteve të pushimit të çështjes, pasi ka dyshime në ekzistencën e faktit, nuk provohet ekzistenca e faktit, i cili përbën vepër penale. Në nenin 328/1, germa “a”,⁸ të K. Pr. Penale, parashikohet se ekzistenca e faktit është kusht për fillimin apo vazhdimin e procedimit penal. Në rastin konkret, pasi janë bërë hetime, nuk është bërë e mundur të provohet ekzistenca e faktit dhe, për këto arsye, procedimi penal nuk mund të vazhdojë më tej, por çështja duhet të pushohet”.

7.3 Në analizë të veprimeve të ndërmarra në arritjen e këtij përfundimi nga ana e subjektit të rivlerësimit, akteve dhe ligjit material e procedural penal, konstatohet se: (i) nga Prokuroria e Rrethit Kurbin është bërë cilësim i gabuar në regjistrimin e veprës penale; (ii) nuk janë kryer veprime hetimore shteruese dhe të mjaftueshme për të dërguar çështjen për gjykim dhe për të identifikuar autorët; (iii) nuk del e qartë pse ky procedim është hetuar nga Prokurori i Rrethit dhe jo nga ndonjë prokuror tjetër i zyrës; (iv) nuk është thirrur për t’u pyetur shtetasi ***. ***; (v) nuk janë bërë verifikime nëse ky shtetas kishte aktivitete të tjera që lidheshin me lojërat e fatit; (vi) nuk janë ballafaquar informacionet e dëshmitarëve; (vii) nuk janë verifikuar tabulatet telefonike etj. Këto mosveprime/gabime të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i ka konsideruar të dukshme, duke i kaluar barrën e provës. Të njëjta konsiderata janë referuar edhe nga vlerësimi i KLP-së për rastin konkret, pjesë e shkaqeve të ankimit.

7.4 Komisioni, pasi ka vlerësuar provat⁹ dhe shpjegimet e subjektit, ka konkluduar se: [...] mangësitë e evidentuara në hetim dhe zvarritja e procesit hetimor janë të drejta. Në gjykim të rrethanave dhe fakteve, prokurori i çështjes nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të cilat do të ligjëronin vendimmarrjen e tij në prova dhe fakte konkrete se përse veprimi nuk përbënte vepër penale. Argumentimi i subjektit është i dobët, sepse ka shumë

⁷ Subjekti i rivlerësimit, në periudhën shkurt 2007 deri më shkurt 2013, ka ushtruar detyrën e drejtuesit të Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.

⁸ Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston.

⁹ Në prapësimet e datës 4.10.2019, subjekti i rivlerësimit depozitoi në cilësinë e provës: analizën vjetore të punës për vitin 2010, për të mbështetur argumentimin se ka pasur ngarkesë në punën e tij si prokuror; grafikun e gatishmërisë me nr. ***, datë ***.4.2010, sipas të cilit rezultoi se subjekti, në datën e regjistrimit të procedimit penal të shtetasit ***, ***, ka qenë prokuror i gatshëm.

elemente dhe veprime hetimore, të cilat duhet të ishin kryer [...]. Në këto kushte, Komisioni ka vendosur transferimin e kësaj çështjeje, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

7.5 Ndërsa në lidhje me të dhënë tjetër të denoncimit për kontaktet e subjektit të rivlerësimit me shtetasin ****. ***.*, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të email-it të datës 21.2.2019, të Komisionit, është përgjigjur se: *“Sa i përket shtetasit ****. ***.*, ju sqaroj se me këtë shtetas nuk kam asnjë lidhje, nuk kam ndonjë raport shoqëror dhe nuk kam pasur marrëdhënie familjare apo të tjera, thjesht e njoh si person”.*

7.6 Ndërkohë, nga hetimi administrativ i Komisionit kanë rezultuar rrethana dhe fakte që dëshmojnë të kundërtën e këtij pohimi të subjektit të rivlerësimit, pasi në datën ****.7.2017*, ora 22:03, midis numrave telefonikë të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit ****. ***.* janë shkëmbyer mesazhe telefonike¹⁰ dhe, se nga të dhënat e sistemit TIMS, rezultojnë kalime të përbashkëta të kufirit shqiptar përmes aeroportit “Nënë Tereza”, duke realizuar fluturime në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin destinacion, më shumë se një herë.

7.7 Sa më sipër, **Komisioneri Publik**, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit dhe Rekomandimit të ONM-së, çmon se çështja nuk duhej të transferohej, pasi mangësitë/mosveprimet nga ana e subjektit të rivlerësimit janë aq të dukshme, sa ato të vetme apo në vlerësimin tërësor të çështjes janë të tilla që mund të vlerësohen bazuar në përcaktimet e nenit E, të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, duke passjellë një vlerësim të ndryshëm për qëllim të procesit të rivlerësimit.

7.8 Rrethanat e rastit konkret në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, referuar nënindikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, duket se, më së paku, paraqesin mungesë të aftësisë së prokurorit për të ndërmarrë logjikisht hetime, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat apo për të interpretuar ligjin. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes për rastin objekt vlerësimi, nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës.

8. Procedimi penal nr. ***, i vitit 2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit), e cila ka shpallur moskompetencën lëndore, duke ia dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet.**

8.1 Në denoncimin e paraqitur për këtë rast, ndër të tjera, pretendohet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ka vendosur moskompetencën lëndore në shkëmbim të favoreve financiare, duke e dërguar çështjen për hetim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, vend në të cilin, më datë ****.7.2017*, ishin sekuestruar 11. 650 kg lëndë narkotike Cannabis sativa.

8.2 Për këtë procedim penal, Komisioni ka kërkuar vlerësim nga ana e KLP-së, në përgjigje të së cilës ky organ është shprehur se: *“... nga shqyrtimi i akteve të fashikullit penal ****/2017*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, konstatohet se përfshirja e subjektit të rivlerësimit në hetimin e këtij procedimi penal është në rolin e drejtuesit të institucionit, konkretisht në administrimin e funksionimit të brendshëm të institucionit në lidhje me shpërndarjen e dosjeve dhe miratimin e shkresave përcjellëse të përpiluara nga prokurorët. Lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje, që është moskompetenca dhe kalimi i akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, Drejtuesi i Prokurorisë për Krime*

¹⁰ Referohuni fashikullit “*****”, në dosje të Komisionit.

të Rënda ka qenë dakord me zgjidhjen e dhënë nga prokurori i çështjes. Firmosja e shkresës përcjellëse është shprehje miratimi nga Drejtuesi i Prokurorisë. Nuk kishin hyrë në fuqi parashikimet e reja ligjore të Kodit të Procedurës Penale.

8.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar rastin, duke arsyetuar se: [...] *Prokuroria për Krimet e Rënda nuk kishte kryer një hetim proaktiv për të identifikuar anëtarët e drejtuesit e grupit të strukturuar kriminal, të cilët po drejtonin një operacion shumë të madh të trafikut të lëndës narkotike, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime. Komisioni, pas prapësimeve të subjektit, ka arritur në përfundimin se: [...] subjekti i rivlerësimit, si drejtues i Prokurorisë, është nënshkruar i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes së moskompetencës datë ***.7.2017, marrë nga prokurori i çështjes... Në konsideratë të faktit se në vlerësimin drejt të situatës konkrete, ku roli i subjektit si drejtues nuk mund të ngarkohet apriori me elemente dyshimi të qëllimshme, trupi gjykues vlerëson se qëllimi duhet të provohet dhe jo të ngrihet mbi bazë hamendësimi [...].*

8.4 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës. Komisioneri Publik vlerëson se, dhe në rastin më të mirë, pa dashur të ngarkojë subjektin me elemente dyshimi, sikurse është shprehur Komisioni, qëndrimi i subjektit dhe mosveprimi i tij, në zbatim dhe të jurisprudencës së Kolegjit, duhet parë dhe vlerësuar në përputhje me parashikimet e nenit E, të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar. Për rastin konkret, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar me përgjegjshmëri detyrat e tij funksionale dhe mekanizmat që ligji i ka mundësuar për të mbikëqyrur ecurinë dhe përfundimin e çështjes, nisur dhe nga rëndësia që paraqiste ajo.

8.5 Ndryshimet e reja ligjore, referuar ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, që kishte hyrë në fuqi, nuk duhen interpretuar në drejtim të mospërgjegjësisë, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të kompetencave udhëzuese që ligji njih për drejtuesin e Prokurorisë dhe nevojën e tyre, në rastin e veprave penale kaq sensitive. Për më tepër që për rastin në fjalë, kompetencat për të vepruar të drejtuesit të Prokurorisë, në raport me prokurorin e çështjes, gjenin ende zbatim në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (i kohës).

8.6 Subjekti i rivlerësimit, posaçërisht për shkak të detyrës funksionale që ushtronte si drejtues i Prokurorisë, kishte të drejtën dhe detyrimin të verifikonte ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, në rastin konkret, mund të udhëzonte me shkrim kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, përpara se nga prokurori i çështjes të merrej vendim mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake, bazuar në nenin 43¹¹, të ligjit nr. 97/2016.

8.7 Në rastin konkret, nuk evidentohet ndonjë komunikim i drejtuesit të Prokurorisë, subjektit të rivlerësimit me prokurorin e çështjes apo që subjekti të ketë udhëzuar me shkrim mbi ecurinë e rastit, pavarësisht faktit nëse këto udhëzime janë apo jo të detyrueshme për zbatim. Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete mund të jepen kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit (neni 48/3 i ligjit nr. 97/2016).

¹¹ Drejtuesi i Prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: a) koordinon veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete; b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji; c) jep urdhra të detyrueshëm për Policinë Gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve; ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake; d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj; dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

9. Procedimi penal nr. */2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit, prej marsit 2016), e cila ka shpallur moskompetencën lëndore dhe aktet ia ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër, ku janë zhvilluar hetime në procedimin penal me nr. ***/2017.**

9.1 Në denoncimin e paraqitur për këtë rast, ndër të tjera, pretendohet se subjekti ka vendosur zëvendësimin e prokurorit pa asnjë shkak dhe në mënyrë të paligjshme. Ka favorizuar të dyshuarit nën hetim dhe se, me firmën e tij, ka përcjellë çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër.

9.2 Për këtë procedim penal, Komisioni ka kërkuar vlerësim nga ana e KLP-së, në përgjigje të së cilës ky organ është shprehur se: *“Vendimi për zëvendësimin e prokurorit është pjesërisht i argumentuar. Është i argumentuar sa i përket evidentimit të zvarritjes së hetimeve, por nuk është i argumentuar sa i përket strukturimit të brendshëm të Prokurorisë. Zëvendësimi i Prokurorit me arsyetimin e organizimit të brendshëm të Prokurorisë nuk është i bazuar në ligj. Lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje, që është moskompetenca dhe kalimi i akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër, Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda ka qenë dakord me zgjidhjen e dhënë nga prokurorët e çështjes. Firmosja e shkresës përcjellëse është shprehje miratimi dhe ende nuk kishin hyrë në fuqi parashikimet e reja ligjore të Kodit të Procedurës Penale”.*

9.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar rastin, duke arsyetuar se: [...] duke pasur parasysh rëndësinë tepër të madhe të çështjes në fjalë dhe sasinë e madhe të lëndës narkotike të gjetur, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrat e tij mbikëqyrëse, duke toleruar mosveprimin fillestar (që zgjati për dy vjet), duke miratuar pas dy vitesh një kërkesë për caktimin e masës “arrest në burg” dhe (në mënyrë kontradiktore) duke miratuar, duke u bazuar në po të njëjtat elemente, transferimin e procedimit penal në Prokurorinë e Shkodrës [...], i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime. Komisioni, pas prapësimeve të subjektit, ka arritur në përfundimin se: [...] subjekti i rivlerësimit, si drejtues i Prokurorisë, është nënshkruar i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes se moskompetencës marrë nga prokurori i çështjes, duke vepruar në respektim të ndryshimeve ligjore të miratuara, konkretisht të ligjit nr. 97/2016 ... dhe udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, ... të Prokurorit të Përgjithshëm, të dalë në zbatim të tij, në respektim të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes, trupi gjykues ka çmuar se nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në funksionin e drejtuesit [...].

9.4 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, bazuar në nenin “E”, të aneksit të Kushtetutës, nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016. Paqartësitë, mangësitë dhe mosveprimi në administrimin dhe hetimin e këtij rasti janë të dukshme, pasi ka rezultuar se:

9.4.1 Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk është kryer asnjë lloj hetimi lidhur me nivelet më të larta të organizatës, duke përfshirë këtu dhe shtetasin ***. ***, në periudhën pas konfiskimit të drogës, për afro dy vite. Ndërkohë gjatë gjithë kësaj periudhe nuk rezultoi e provuar që subjekti të ketë komunikuar me prokurorin e çështjes, të jetë përpjekur të informohet apo të adresojë problematikat.

9.4.2 Provohet fakti se subjekti i rivlerësimit, më së paku, në periudhën kohore nga marsi 2016 deri më 26 nëntor 2016, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, ka pasur

kompetenca të plota veprimi mbi çështjen. Kompetenca këto të cilat ia njëjtte edhe Kodi i Procedurës Penale. Në cilësinë e drejtuesit, subjekti, vetëm pas një viti, ka vendosur të zëvendësojë prokurorin e ngarkuar, me argumentimin që ka konstatuar zvarritje të hetimeve dhe nevojën për ecurinë e tyre, megjithëse, sikurse ka pranuar në parashtrimet e tij para Komisionit, ka qenë i vetëdijshëm për seriozitetin, problematikat dhe rëndësinë e çështjes në hetim.

9.5 Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e identifikuar, të përsëritura, janë të tilla që mundësojnë vlerësimin mbi kriterin e aftësisë profesionale, në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe në jurisprudencën e Kolegjit.

10. Procedimi penal nr. */2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (për periudhën maj 2015 - mars 2016, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e zëvendësdrejtuesit e më pas atë të drejtuesit), dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, ku janë zhvilluar hetime në procedimin penal me nr. ***/2016.**

10.1 Në denoncimin e paraqitur për këtë rast, ndër të tjera, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka vendosur moskompetencën, duke e kaluar çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, me qëllimin e vetëm që dosja të mbyllej në këmbim të përfitimeve financiare.

10.2 Për këtë procedim penal, Komisioni ka kërkuar vlerësim nga ana e KLP-së, në përgjigje të së cilës, ky organ është shprehur se: “... nga aktet e administruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, konstatohet se nuk ka vendim zëvendësimi dhe se veprimet hetimore janë ndjekur nga prokurori ***, ***. Ndërsa vendimi i shpalljes së moskompetencës, në datën ***.5.2016, është përpiluar nga Drejtuesi i Prokurorisë Besim Hajdarmataj. Nuk rezulton të ketë në fashikull akt që argumenton arsyen, përse vendimi i moskompetencës është përpiluar nga drejtuesi i institucionit”. Po ashtu, KLP referon se nuk mund të shprehen për bazueshmërinë ose jo të vendimit të zëvendësimit për aq kohë sa nuk gjendet një i tillë në fashikull, nëse Prokurori i ngarkuar fillimisht me hetimin e procedimit ka hequr dorë apo ka dhënë pëlqimin për zëvendësimin e tij. Gjithashtu, nuk del qartë arsyeja pse procedimi është ndjekur nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe jo nga ndonjë prokuror tjetër i linjës përkatëse.

10.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar rastin, duke arsyetuar se: [...] nuk rezulton që të jenë kryer veprime të mëtejshme hetimore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për të verifikuar nëse ka pasur persona të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet, si dhe nuk u arrit të zbardhej dhe të konkludohej se cili ishte destinacioni i sasisë së lëndës narkotike të gjetur që do të trafikohej [...], i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime. Komisioni, pas prapësimeve të subjektit, ka arritur në përfundimin se: [...] vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, në datën ***.5.2016, i përpiluar nga drejtuesi i Prokurorisë, z. B. Hajdarmataj, është hartuar nga ana formale në përputhje me ligjin procedural penal, bazuar në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohej shprehimisht se prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e prokurorit më të ulët. Vlerësimet dhe konstatimet e paraqitura nga Komisioni i referohen hetimeve shteruese, që duhet të ishin kryer për këtë çështje, të cilat i përkasin prokurorit të çështjes [...].

10.4 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, paragrafin 5, të nenit “E”, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016, për sa rezulton nga rasti konkret, ku:

10.4.1 Për nga sasia e drogës së sekuestruar, personave të përfshirë, mangësive të konstatuara, nuk duket bindëse ndryshimi i cilësimit të veprave penale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nuk rezulton që të jenë dokumentuar hetime mbi lëvizjet financiare të të dyshuarve apo të jenë monitoruar telefonatat e tyre, me qëllim identifikimin e personave të tjerë të implikuar apo të konkludohej nëse rasti kishte karakter ndërkombëtar.

Fakti që gjykata dënoi të pandehurit për një veprë penale të një rrezikshmërie më të ulët, si: “Prodhim dhe shitje e bimëve narkotike”, ashtu siç argumenton, ndër të tjera, dhe subjekti, nuk justifikon mungesën e hetimeve nga ana e Prokurorisë, pasi gjykatës nuk iu vu në dispozicion asnjë element apo provë tjetër, në bazë të së cilës ajo mund të vendoste ndryshe.

10.5 Komisioneri Publik, dhe për këtë rast, vlerëson se gjetjet e identifikuara, të natyrës përsëritëse, janë të tilla që mundësojnë vlerësimin mbi kriteret e aftësisë profesionale apo në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe në jurisprudencën e Kolegjit.

11. Procedimi penal nr. */2012, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kjo e fundit ka shpallur moskompetencën tokësore, duke ia kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës (ku subjekti ka qenë drejtues 2013-2015), regjistruar me nr. ***/2013.**

11.1 Në denoncimin e paraqitur për këtë rast, ndër të tjera, pretendohet se në këmbim të favoreve financiare, subjekti ka ndërhyrë në dosje pa asnjë akt ligjor të shkruar, qoftë dhe formal, duke hequr nga hetimi prokuroren e çështjes, ***. ***, në kundërshtim me nenin 27, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe ka vendosur në kundërshtim me ligjin moskompetencën, me arsyetimin e vetëm se Elbasani është rreth më i afërt me Tiranën se Durrësi. Ndërkohë që kishte më shumë se një vit që kishte pranuar kompetencën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

11.2 Në analizë të gjetjeve nga studimi i akteve të procedimit penal, fillimisht, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *arsyetimi për transferimin e çështjes është i dobët dhe nuk qartëson këndvështrimin se përse roli i shtetasit ***. ***, do të përbënte bazë për transferimin e çështjes, duke cituar arsyet e mundësisë (duke paragjykuar çështjen), argumente që nuk qëndrojnë ligjërisht. Në çdo rast, është e qartë se prokurorit të cilit i është ngarkuar çështja, ishte znj. ***. ***, e cila kishte kryer hetimin e çështjes dhe kishte planifikuar hapa të mëtejshëm hetimorë, kur drejtuesi i Prokurorisë ndërhyri, duke urdhëruar transferimin e çështjes në një qytet tjetër. Në lidhje me arsyen e dytë të përmendur nga subjekti në vendim për transferimin e çështjes, se distanca e Tiranë - Elbasan është më e shkurtër se distanca Tiranë - Durrës, duket i paqartë ky argument i përdorur, sepse këtë fakt subjekti kishte mundësi që ta konstatojë që në momentin e regjistrimit të procedimit penal [...]. Sa më sipër, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime.*

11.3 Komisioni, pas propësimeve të subjektit, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit, vendimin për shpalljen e moskompetencës, e ka mbështetur në ligjin referuar të drejtës funksionale, si drejtues i Prokurorisë për të ndërhyrë. Ai ka ushtruar kompetencat si*

prokuror më i lartë, në përputhje me parashikimet e nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me faktin që pretendimet e ngritura nga denoncuesi janë gjykuar edhe nga gjykatat më të larta që kanë marrë në shqyrtim çështjen, trupi gjykues çmon se nuk ka kompetencë për të hyrë në themel të çështjes mbi atë që gjykatat më të larta kanë vendosur [...].

11.4 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016. Nga aktet e administruara rezultojnë këto fakte:

11.4.1 Subjekti i rivlerësimit, duke marrë çështjen nga prokurorja e ngarkuar, *****. ***.**, dhe duke ndërmarrë vendimin final të shpalljes së moskompetencës, praktikisht, ka ngarkuar veten si prokuror i çështjes, duke marrë përsipër hetimin dhe të metat e tij. Për më tepër vlen të përmendet se nga subjekti, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk rezulton të jetë administruar vendim për zëvendësimin e prokurorit, gjë që bie ndesh dhe me vetë parashikimet ligjore të kohës mbi organizimin e Prokurorisë dhe dispozitat e K. Pr. Penale.

11.4.2 Arsyetimi i subjektit është i paplotë dhe i paqartë, në drejtim të nevojës që çështja të trajtohej nga ana e tij, në kushtet kur tashmë hetimi kishte filluar dhe prokurorja *****. ***.** kishte përcaktuar ndërkohë dhe hapat e mëtejshëm për ecurinë e tyre.

11.4.3 Baza ligjore e referuar nga subjekti në arsyetimin e vendimit për transferimin e çështjes, me atë të dispozitivit, është e ndryshme, pasi është disponuar mbi bazën e nenit 76, në vend të nenit 78 të K. Pr. Penale, por, edhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, për lapsus, sërish nuk jemi para rastit kur gjen zbatim neni 78 i K. Pr. Penale. Neni 78 mund të zbatohet vetëm kur gjyqtari/prokurori merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, ndërsa (në kundërshtim me këtë rast), subjekti e ka zbatuar këtë dispozitë duke iu referuar rastit të vëllait të një prokurori. Ky i fundit as nuk ka qenë i regjistruar si i dyshuar në momentin e marrjes së vendimit dhe as më pas.

11.4.4 Gjithashtu, argumentimi se qytetit i Elbasanit është më afër Tiranës se Durrësi, është jo bindës, i papajtueshëm me rrethanat dhe faktet, pasi në Prokurorinë e Durrësit janë transferuar plot raste të moskompetencës së Prokurorisë së Tiranës me bazë ligjore nenin 78 të K. Pr. Penale. Në mënyrë të pakuptimtë, ky arsyetim aplikohet në fazën përfundimtare të hetimit.

11.5 Komisioneri Publik vlerëson se, dhe në këtë rast, qëndrimi dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, përveç se nuk janë bindëse dhe të mirëbazuara, nuk provuan të kundërtën e barrës së provës. Gjetjet nga analiza e rastit duken se janë të tilla që mund të vlerësohen sipas përcaktimeve të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit.

12. Në përfundim të sa më sipër parashtruar, në analizë të fakteve të dala nga hetimi, Komisioneri Publik vlerëson se për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale:

12.1 Subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës lidhur me çështjet dhe denoncimet e shqyrtuara. Transferimi i çështjes me nr. akti *****/2010**, pranë organit kompetent për inspektim, nuk është i bazuar, si dhe nuk gjen mbështetje në jurisprudencën e Kolegjit.

12.2 Subjekti i rivlerësimit, herë në cilësinë e prokurorit të çështjes dhe herë në atë të drejtuesit të Prokurorisë, ka dështuar të kryejë veprime procedurale të nevojshme, ato hetimore për çështjet penale të trajtuara prej tij, në zbatim të legjislacionit të zbatueshëm.

12.3 Për qëllim të vlerësimit të këtij kriteri, bazuar në parashikimet e nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016, konstatojmë se mangësitë e vërejtura janë të tilla që nuk justifikojnë dhe nuk të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë. Mangësitë e konstatuara, të natyrës përsëritëse dhe vazhduese, duhen vlerësuar nga ana e Kolegjit në kuadër të juridiksionit të tij rivlerësues, referuar kërkesave të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

I.B. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

13. Lidhur me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën “Vetting”, pasuri të luajtshme në formën e depozitave bankare dhe kursimeve të poseduara në *cash*¹², nga analiza financiare e kryer për periudhën 2003-2016, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare, përkatësisht për vitet 2010-2013, me një diferencë negative prej – 980.888 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, diferencë për të cilën Komisioni i ka kaluar subjektin barrën e provës.

13.1 Pas prapësimeve të subjektit, Komisioni ka rishikuar zërat përbërës të analizës financiare lidhur me: (i) të ardhurat nga bonusi i karburantit; dhe (ii) shpenzimet e jetesës dhe, në përfundim, ka konkluduar se: [...] *subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme financiare për të krijuar depozitat e deklaruara, kursimet cash dhe për të mbuluar shpenzimet [...].*

13.2 **Komisioneri Publik** vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të fakteve të administruara, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, pasi në analizën financiare të rikryer nga Komisioni nuk duhet të ishin konsideruar: (i) Pretendimet e subjektit mbi kursimet e krijuara me burim nga të ardhurat nga bonusi i karburantit, duke justifikuar shpenzimet e transportit me deklaratimet e subjektit, shoqëruar me deklarata noteriale të kryera vetëm gjatë hetimit administrativ. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces. (ii) Pretendimet e subjektit për rishikimin e shpenzimeve të jetesës, pretendime të ngritura pas kalimit të barrës së provës, në kundërshtim me deklaratimet e mëparshme të vetë subjektit¹³.

13.3 Përveç sa më sipër, nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga ana e Komisionit, pjesë e dosjes së hetimit administrativ, rezulton se, përtej deklaratimeve të subjektit, janë rishikuar edhe shpenzimet e udhëtimit.

13.4 Në përfundim, mbështetur dhe në jurisprudencën e Kolegjit, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të përdorura për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive likuiditete *cash* dhe në sistemin bankar, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket të ardhurave të deklaruara të dhuruara nga vëllai ***, ***, në shumat 3.000 euro dhe 4.000 £, kursime në *cash* të deklaruara të poseduara nga subjekti në momentin e plotësimit të Deklaratës “Vetting”, në vlerësimin e Komisionerit Publik mbeti i paprovuar

¹² Konstatohet se për gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën “Vetting” tej limitit ligjor prej 1.5 milionë lekësh, të përcaktuar nga shtojca nr. 2, e ligjit nr. 84/2016.

¹³ Subjekti, paraprakisht, ka deklaruar masën e kontributit mujor në familje në vlerën 25.000 - 30.000 lekë në muaj.

burimi i ligjshëm i personit tjetër të lidhur, për të mbuluar shumat e dhuruara dhe njëkohësisht investimet e deklaruara në pasurinë që do të trajtohet në vijim.

14. Banesa në përdorim. Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në posedim apo përdorim. Për periudhën nga maji i vitit 2009 e në vijim, subjekti ka deklaruar se banon në adresën: Njësia Administrative nr. ***, rruga “**** **”, pallati nr. ***, shk. ***, ap. ***/***, Tiranë, adresë që i përket shtëpisë së vëllezërve të tij, ***, dhe ***, ***.¹⁴ Subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer:

- (i) *Shuma prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro, dërguar nga vëllai ***, ***, (emigrant në Mbretërinë e Bashkuar);*
- (ii) *Shuma prej 1.000.000 (një milion) lekë, dërguar po nga vëllai ***, ***, për të mbuluar shpenzimet e mobilimit të apartamentit;*
- (iii) *Diferenca prej 22.580 (njëzet e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë) euro, investuar nga vëllai ***, ***, me burime përkatësisht: 10.000 euro (dhjetë mijë) hua nga shtetasi ***, ***, dhe pjesa tjetër, mbuluar nga kursimet personale;*
- (iv) *Shuma prej 100.000 lekë (njëqind mijë), për mobilimin e dhomës në përdorim nga subjekti është mbuluar nga të ardhurat e vetë subjektit.*

14.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime dhe të paraqesë prova, për të evidentuar mundësinë financiare të vëllezërve të tij për blerjen e kësaj pasurie¹⁵. Subjekti ka paraqitur prova mbi të ardhurat e vëllait ***, ***, nga puna në emigracion në Mbretërinë e Bashkuar, prova dhe dokumente mbi të ardhurat e vëllait ***, ***, si dhe një deklaratë noteriale, të datës ***.11.2018, hartuar dhe nënshkruar nga shtetasi ***, ***, dhe ***, ***, ku evidentohet huaja e marrë nga i vëllai ***, ***, në vitin 2007 dhe kthimi i saj.

14.2 Komisioni, në vijim ka arsyetuar se: [...] *kur nuk rezultojnë nga aktet e administruara nga hetimi të dhëna apo dyshime që kjo pasuri është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, situatë e cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, çmon se detyrimi i subjektit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij apartamenti është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, trupi gjykues vlerëson se shtrirja e hetimit edhe te pronat e familjarëve të tjerë nuk mund ta ngarkojnë subjektin me një barrë përtej asaj që ligjërisht është ngarkuar të mbajë si subjekt deklarues, pasi del jashtë qëllimit të ligjit [...].*

14.3 **Komisioneri Publik**, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit mbi proporcionalitetin dhe kufijtë e hetimit mbi personat e lidhur/tjerë të lidhur, vlerëson se detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, nuk është në tejkalim të parashikimeve ligjore, përkundrazi është detyrim kushtetues dhe ligjor në kuadër të procesit të rivlerësimit.

14.4 Duke mbajtur në konsideratë vlerësimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij lidhur me cilësimin e personave të lidhur/tjerë të lidhur, duke ndërthurur vlerësimin logjik e të arsyeshëm të të gjitha rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ i kryer në Komision,

¹⁴ Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore ka rezultuar se subjekti ka ndryshuar disa herë adresën e banimit/qëndrimit. Nga aktet në dosje rezulton se kjo pasuri është porositur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., të datës ***.9.2007, nënshkruar midis shoqërisë “**** **” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe shtetasis ***, ***, në cilësinë e porositësit, për vlerën 52.580 euro, e cila, sipas përcaktimeve të kontratës, është shlyer plotësisht në momentin e hartimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.

¹⁵ Referohuni pyetësorëve në dosjen e subjektit.

Komisioneri Publik vlerëson se vëllai ***, ***, në kuptim të nenit 3, pika 13, të ligjit nr. 84/2016, merr cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Ndërsa, vëllai tjetër, ***, ***, merr cilësinë e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të shumave të dhëna si dhurata subjektit të rivlerësimit. Në këto rrethana, subjektit i lind detyrimi ligjor të provojë saktësinë e deklarimeve mbi këtë pasuri, si dhe burimin e ligjshëm të saj, pasi nga hetimi ka rezultuar se:

- 14.4.1 Vëllai ***, ***, së bashku me familjarët e tij kanë qenë në një certifikatë familjare me subjektin e rivlerësimit deri në shtator të vitit 2016 (*banesa është blerë në vitin 2007*), vit në të cilin, nga aktet e vëna në dispozicion nga gjendja civile, rezulton që subjekti ka kërkuar shkëputjen me argumentimin se jeton i vetëm¹⁶. Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij (*6 anëtarë*) jetojnë në të njëjtën banesë, në të cilën subjekti deklaron se përdor një dhomë, të mobiluar me shpenzimet e tij.
- 14.4.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kursimet në *cash*, në fillim të vitit 2009 dhe në fund të vitit 2009, kanë si burim të ardhurat nga paga e tij, paga e vëllait ***, ***, dhe të ardhurat e dërguara nga vëllai ***, ***. Kursimet në *cash* të akumuluar deri në datën 31.12.2016 (duke përfshirë dhe ato deri në vitin 2009) janë depozituar nga subjekti në depozitat bankare në emrin e tij dhe deklaruar në posedim nga subjekti në Deklaratën “Vetting”. Cilësimi si person tjetër i lidhur, për shkak të këtij interesi pasuror, vjen dhe në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.
- 14.4.3 Nga aktet rezultoi se në familjen e vëllait ***, ***, vetëm ky shtetas është në marrëdhënie punësimi, pa llogaritur këtu subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, diferenca negative në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, në kushtet e provuara të ekonomisë së përbashkët familjare, do të thellohej dhe më tej.
- 14.4.4 Nga hetimi administrativ, sikurse deklaron dhe subjekti, rezultoi se në të njëjtat vite në të cilat subjekti ka marrë në formën e dhuratës nga vëllai ***, ***, (shumat 3.000 euro dhe 4.000 £), pjesë e pasurisë, kursime të deklaruara të poseduara në *cash*, trajtuar në pikën 13.4, ky i fundit ka investuar dhe ka financuar për banesën në të cilën aktualisht jeton edhe subjekti, në vlerën prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro dhe 1.000.000 (një milion) lekë.

14.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit dhe në legjislacionin e zbatueshëm, vlerëson se, për sa i përket burimeve të ligjshme të vëllait ***, ***: (i) nuk provohet mundësia financiare e tij për të përballuar këto shpenzime¹⁷; (ii) nuk provohet mënyra e transferimit të këtyre shumave në Shqipëri, si dhe nuk është bindës dhe nuk mbështetet në aktet e administruara në dosje pretendimi dhe deklarimi i subjektit se këto shuma janë sjellë sa herë që i vëllai ka ardhur në Shqipëri¹⁸, duke mos e bërë bindës dhe burimin

¹⁶ Referuar qëndrimin të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 13/2019, prg. 81. Deklarimi përfshin pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit dhe personave të lidhur, përfshirë interesat private, që i ka në pronësi, posedim ose në përdorim, në përputhje me ligjin. Persona të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, janë rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person i përmendur në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, për subjektin e rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit.

¹⁷ Për më tepër, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, përveç se nuk është në formën e kërkuar ligjore për vlefshmërinë dhe administrimin e tij, sipas kërkesave të K. Pr. Civile, dhe jurisprudencës së Kolegjit, nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm për të konfirmuar mundësinë financiare të vëllait.

¹⁸ Nga të dhënat e sistemit TIMS, për periudhën që subjekti pretendon se kanë ardhur këto shuma, udhëtimet e të vëllait janë një hyrje-dalje në vitin 2006 dhe deri në momentin e blerjes së banesës (shtator 2007), nuk ka asnjë hyrje-dalje.

e ligjshëm të shumave 3.000 euro dhe 4.000 £, të deklaruara si kursime të poseduara në *cash*, në momentin e plotësimit të Deklaratës “Vetting”.

14.6 Për sa i përket burimeve të ligjshme të vëllait ***. ***, nga aktet në dosje rezultojnë se nuk provohet mundësia financiare e tij, për të financuar shumën e deklaruar nga subjekti për blerjen e pasurisë, sikurse nuk ka prova bindëse për të konfirmuar ekzistencën e huas, e marrë prej vëllait, shtetasit ***. ***, si dhe mundësinë financiare të tij për të shlyer huan deri në vitin 2012¹⁹.

14.7 Për sa më sipër, në analizë të fakteve dhe të rrethanave objektive të dala nga hetimi administrativ për këtë pasuri, duket se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë ndryshe pasuritë në përdorim të tij dhe burimin real që ka shërbyer për krijimin e tyre, bazuar në parashikimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës.

I. C. Çështje të tjera/ vlerësimi tërësor i procedurave

15. **Përdorimi i makinës/kontaktet.** Gjatë hetimit administrativ, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)²⁰ ka informuar Komisionin se shoqëria “****” sh.a. ka lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit policën e sigurimit TPL, me numër serie ***, për një periudhë mbulimi: datë ***.12.2010 - datë ***.12.2011. Kjo policë sigurimi ishte lëshuar për një automjet tip “Audi A4”, në pronësi të shtetasës *** ***, me përdorues z. Besim Hajdarmataj.

15.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 24.11.2018, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Nuk më rezultojnë të kem dijeni rreth këtyre siguracioneve dhe po ashtu s’kam dijeni për automjetet në fjalë. Nuk jam paraqitur ndonjëherë pranë ndonjë kompanie sigurimi për të kërkuar, paguar ose kërkuar siguracione sipas këtyre të dhënave të mësipërme. Unë nuk njoh asnjërin nga personat, të cilët paraqiten si pronarë të këtyre automjeteve”*. Ndërsa në përgjigje të email-it të datës 12.12.2018, në përgjigjet e pyetësorit nr. 7, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Jam shumë i surprizuar në lidhje me policën e sigurimit për vitin 2010 - 2011, ku ndodhet dhe emri i vëllait tim, ***. I kam kërkuar shpjegime vëllait tim lidhur me këtë fakt dhe më ka sqaruar se: “E kam paguar unë këtë policë, por nuk ju kam bërë me dije, pasi nuk e kam vlerësuar këtë fakt”*.

15.2 DPSHTRR-ja²¹ ka informuar se, nga verifikimet e bëra në sistemin informatik, ka rezultuar se automjeti tip “Audi”, me ngjyrë të zezë, me nr. shasie: ***, nuk figuron i regjistruar. Po ashtu ka informuar se shtetasja *** *** nuk ka automjete të regjistruara pranë DPSHTRR-së.

15.3 Përveç sa më sipër, Komisioni ka ardhur në dijeni të kontakteve të subjektit me persona me precedentë penalë, si dhe të faktit se ka udhëtuar me ta dhe me makinat e tyre. Në këtë drejtim, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi, ndryshe nga faktet e administruara, pretendon se nuk ka asnjë njohje me ta. Por, sikurse rezultoi dhe në rastin me shtetasin ***. ***, (rasti i Kurbinis), ku subjekti kishte kontakte telefonike dhe udhëtime, nga aktet rezultoi e provuar se subjekti ka udhëtuar edhe me shtetasit ***. ***, dhe ***. ***, të dy të proceduar penalisht.

15.4 **Komisioneri Publik**, në analizë të akteve të administruara, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit, bazuar në nenin 4, pika 2, vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ, mbartin në vete dyshimin e arsyeshëm për kontakte të subjektit të

¹⁹ Komisioni ka kërkuar informacion nga ILDKPKI-ja lidhur me deklarimin e interesave private të subjektit, ***. ***. (duke qenë subjekt deklarues), nga e cila ka rezultuar se i vëllai i subjektit ka deklaruar të njëjtën pasuri me pjesë takuese 100%.

²⁰ Me shkresën nr. ***/***, datë ***.11.2018.

²¹ Në përgjigje të kërkesës së Komisionit ka informuar me shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.12.2018.

rivlerësimit me persona me precedentë penalë, fakt i cili duhet çmuar në vlerësimin tërësor të çështjes, pasi ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të rivlerësimit të rëndojë edhe parashikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

II. Kërkimi i ankimit

16. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

17. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

18. Në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-34, 40-44, nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zotit Besim Hajdarmataj.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA